

1. Të Dhëna të Përgjithshme dhe Shasia

- **Konfigurimi i akseve:** 4X2.
- **Destinacioni i shasisë:** E projektuar dhe e përshtatshme për ndërtim automjeti zjarrfikës.
- **Trashësia e shasisë** Jo më pak se 7 mm
- **Sistemi i drejtimit:** Timon hidraulik me asistencë variabile.
- **Lyerja e shasisë:** Trajtim i plotë mbrojtës antikorroziv i shasisë dhe kabinës.

2. Dimensionet dhe Peshat

- **Pesha totale e lejuar:** Midis 17,500 kg dhe 18,500 kg
- **Kapaciteti teknik i ngarkesës :** Jo më pak se 12,500 kg
- **Hapësira midis akseve :**Në gamën 4,300 mm deri 4,500 mm
- **Gjatësia e mundshme e karrocërisë** Lejohet montim karrocërie nga 5,200 mm deri në maksimum 5,700 mm
- **Gjatësia e përgjithshme e shasisë:** Midis 7,400 mm dhe 7,600 mm
- **Lartësia maksimale e kabinës (pa ngarkesë):** Jo më shumë se 3,200 mm nga fenalinat
- **Kapaciteti teknik i aksit të parë:** Jo më pak se 7,000 kg
- **Kapaciteti teknik i aksit të pasëm:** Jo më pak se 11,500 kg
- **Rrezja e kthimit (muri në mur / overall):** Jo më shumë se 8,600 mm}
- **Gjerësia e kabines 2,500 mm pa pasqyra nga jashte**
- **Gjerësia e kabines nga brenda te jete jo me pak se 2,200 mm**
- **Gjatesia e kabines nga brenda (nga xhami i pare deri ne fund te saj) te jete jo me pak se 3,200 mm**

3. Motori dhe Performanca

- **Tipi i motorit:** Diesel, me 6 cilindra në rresht, me injeksion direkt me presion të lartë (sistem Common Rail).
- **Volumi i motorit:** Në gamën 7.5 litra deri në 8.0 litra.
- **Fuqia maksimale e motorit:** Jo më pak se 205 kW
- **Sistemi i mbingarkimit:** Turbo me gjeometri të ndryshueshme (VGT) dhe ndërfatje ftohjeje.

- **Standardi i ndotjes:** Minimumi EURO VI.
- **Mbrojtja nga ngrirja:** Lëngu ftohës (antifrizi) rezistent deri në -40

4. Transmisioni dhe Marrësi i Fuqisë (PTO)

- **Kutia e marsheve:** Transmision automatik , me minimum 8 marshe përpara.
- **Sistemi i ftohjes së transmisionit:** I pajisur me ftohës të dedikuar për vajin e kësaj kutie.
- **Marrësi i Fuqisë (PTO):** I montuar në kutinë e marsheve, i përshtatshëm për operacione të rëndësishme/zjarrfikëse, me kapacitet momenti jo më pak se 350 Nm dhe dalje standarde me flanxhë (p.sh. DIN90).
- **Aksi i pasëm:** Me bllokues integral të diferencialit.

5. Sistemi i Frenimit dhe Siguria

- **Sistemi i frenave:** Frena me disqe në të dy akset, me dy qarkore të pavarura me ajër.
- **Sistemet elektronike standarde:** ABS, ASR, EBS, ESC (kontrolli i stabilitetit dhe kundër rrokullisjes) dhe asistencë për nisjen në përpjetë.
- **Frena ndihmëse:** Retarder / frenë shkarkimi me kapacitet jo më pak se 110 kW në xhiro të larta.
- **Sistemet e asistencës aktive:**
 - Sistem automatik i frenimit të emergjencës (AEBS).
 - Cruise Control Adaptiv (ACC).
 - Sistem i paralajmërimit të ndryshimit të korsisë (LDWS).
 - Radar ose sensorë anësorë për mbulimin e pikave të vdekura në të dyja anët.

6. Kabina dhe Pajisjet e Brendshme

- **Konfigurimi i kabinës:** Kabinë e zgjatur, me strukturë me 4 dyer (për ekuipazh të zgjeruar).
- **Ndenjësja e shoferit:** Me suspension ajri dhe e rregullueshme.
- **Pjesa e poshtme e kabines nga brenda te jet e veshur me material kundra rreshqitjes dhe ujit**
- **Ndenjëset e pasagjerëve:** Bankinë për të paktën 1 shofer dhe 1 pasagjerë në rreshtin e parë dhe 4 pasagjere mbrapa dhe ne cdo sedilje mbrapa te jete e montuar vendi per vendosjen e aparateve te frymemarrjes
- **Sistemi i klimatizimit:** Kondicioner fabrike me rregullim manual ose automatik.

- **Sistemi i ndërlidhjes:** Radio me mbështetje për transmetime digjitale, Bluetooth për lidhje telefonike dhe doreza komandimi në timon.
- **Sistemi i kamerave:** Ndërfaqe e instaluar për kamerë të pasme (reversing camera) me gjatësi kabllimi jo më pak se 4 mm

7. Rrotat, Rezervuari dhe Pajisje të Tjera

- **Dimensioni i gomave:** min 305/70 R 22.5.
- **Sistemi i monitorimit të gomave:** Sensorë të kontrollit të presionit të gomave sipas standardit ISO.
- **Kapaciteti i rezervuarit të naftës:** Jo më pak se 130 litra, i përbërë nga material polimer/plastik, me ngrohës të integruar në filtrin e karburantit.
- **Rezervuari AdBlue:** Jo më pak se 30 litra, i pozicionuar brenda strukturës së shasisë.
- **Pajisje ndihmëse:** Krik hidraulik (kapacitet minimum 10 ton) trekëndësh, drita ditore LED, zhumues i marshit të pasmë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MBINDËRTIMIT

1. KarrocERIA dhe Ndarjet e Magazinimit (Bodywork & Storage)

- **Materiali i strukturës:** Karroceri e ndërtuar me strukturë alumini të certifikuar, e mbuluar në pjesën e përparme dhe të pasme me pllaka alumini. Dyshemeja të jetë tërësisht prej alumini.
- **Montimi në shasi:** Rezervuarët e ujit dhe shkumës të montohen mbi një nënshasi të përforcuar të tipit shkallë (heavy duty subframe). Nënshasia duhet të lidhet me shasinë kryesore të kamionit nëpërmjet amortizatorëve të përforcuar prej gome/çeliku, duke minimizuar përdredhjet dhe stresin strukturor gjatë lëvizjes jashtë rrugë (off-road) dhe në kthesa, duke garantuar stabilitet të lartë.
- **Ndarja e pompës:** E pozicionuar në pjesën e pasme të automjetit, e mbyllur me grilë rrotulluese prej alumini.
- **Kabinat e magazinimit të pajisjeve :** Minimumi 5 ndarje magazinimi
 - Minimumi 5 dollapë të pozicionuar midis kabinës së shoferit dhe rezervuarit (2 në anën e majtë dhe 2 në anën e djathtë), 1 në fund të karrocerisë ku të jetë i montuar agregati i pompës luftuese.
 - Minimumi 3 dollapë të pozicionuar pas rezervuarit të ujit (1 në të majtë, 1 në të djathtë dhe 1 në pjesën e pasme).

- **Grilat e dollapëve:** Të mbyllura me grila rrotulluese prej aliazhi të lehtë, rezistente ndaj pluhurit dhe ujit. Dizajni me mbrojtje të dyfishtë duhet të garantojë hapjen në çdo kohë. Hapja e grilave duhet të aktivizojë automatikisht një dritë sinjalizuese brenda kabinës së shoferit. Brenda dollapeve të jete të organizuara vendet për të vendosur minimumi 20 tuba dhe sirtare për të vendosur vegla të ndryshme
- **Ndriçimi i dollapëve:** Çdo ndarje magazinimi duhet të ketë ndriçim të dedikuar për operacionet e natës, i cili ndizet automatikisht me hapjen e grilës. Ndarjet duhet të kenë dizajn të veçantë që parandalon grumbullimin e ujit.
- **Kuverta e çatisë:** E mbuluar plotësisht me pllaka alumini të profilizuar kundër rrëshqitjes (chequered plates) ose veshje gome kundër rrëshqitjes, e përshtatshme për ecje mbi zonën e dollapëve dhe rezervuarit. Mbi çati duhet të instalohen mbajtëse specifike për minimumi 3 tuba thithës dhe 1 shkallë të zgjatueshme.
- **Shkalla e aksesit:** Në pjesën e pasme të karrocerisë të jetë e montuar në mënyrë permanente një shkallë metalike e përforcuar për ngjitjen në çati.
- **Parmakët e çatisë:** Të instaluar përgjatë skajeve të çatisë, prej aliazhi të lehtë.
- **Shkallët e palosshme:** Nën dollapët e pajisjeve të instalohen shkallë të palosshme me arnotizator dhe me sipërfaqe kundër rrëshqitjes për akses të lehtë. Gjatë lëvizjes së mjetit, ato duhet të palosen lart
- **Mbrojtëset e baltës** Të montuara në aksin e pasëm.
- **Ne fund të automjetit të vendoset një prozhektor për ndricim nate dhe të jete i rrotullueshem 360 grade**
- **Automjeti të disponojë dy barabane një majtas dhe një djathtas me gjatësi minimumi 70 m secili ku të jete të pajisura me hedhese profesionale si dhe hapja dhe mbledhja e tyre të jete automatike dhe mekanike.**

2. Rezervuari i Ujit

- **Kapaciteti:** Jo më pak se 5,000 lt.
- **Depozita e shtrire horizontal**
- **Materiali:** Çelik inoks i cilësisë së lartë, minimumi AISI 304.
- **Trashësia e mureve:** Jo më pak se 4 mm
- **Dizajni:** Qendra e gravitetit të jetë sa më e ulët e mundshme. I pajisur me pllaka të brendshme thyerëse të dallgëve (valëve) gjatësore dhe tërthore (baffle plates) për të qetësuar lëvizjen e ujit gjatë marshimit.
- **Pajisjet e rezervuarit:**

- Minimumi 1 pusete kontrolli me diametër jo më pak se 500 mm, me kapak alumini me mbyllje të shpejtë hermetike për mirëmbajtje dhe pastrim.
- 1 tub shkarkimi/ajrimi që shkarkon nën automjet pas aksit të pasmë.
- Minimumi 1 linjë mbushjeje nga hidranti me rakord lidhës.
- 1 fllanxhë për linjën e mbushjes nga pompa në rezervuar, e pajisur me valvul sferike.
- 1 indikator manual i nivelit të rezervuarit.
- 3 fllanxhë për linjën e thithjes nga rezervuari te pompa, e pajisur me valvul.
- 2 rubinet shkarkimi i lidhur në pikën më të ulët të rezervuarit.

3. Rezervuari i Shkumës (Foam Tank)

- **Kapaciteti:** Jo më pak se 500 lt
- **Materiali:** Çelik inoks rezistent ndaj korrozionit, minimumi AISI 316.
- **Trashësia e mureve:** Jo më pak se 3 mm
- **Pozicioni dhe dizajni:** I integruar brenda rezervuarit të ujit, me qendër graviteti sa më të ulët të mundshme.

4. Njësia e Pompës

- **Tipi:** Pompë e kombinuar me presion normal dhe presion të lartë.
- **Materiali:** Alumini rezistent ndaj ujit të kripur, me bosht (shaft) prej çeliku inoks.
- **Operimi:** Aktivizimi/çaktivizimi i PTO-së së pompës të bëhet nga brenda kabinës së shoferit; të gjitha komandat e tjera operuese të kryhen nga paneli i pasëm i pompës.
- **Performanca (Prurja):**
 - Presioni Normal: Jo më pak se 3,000 lt/ m në një presion prej 10 bar.
 - Presioni i Lartë: Jo më pak se 250 lt/min në një presion prej 40 bar.
- **Pozicioni:** E montuar në pjesën e pasme të automjetit.
- **Lidhjet (Daljet/Hyrjet):**
 - Minimumi 1 hyrje thithëse me diametër 4 me rakord lidhës, filtër dhe kapak të verbër me zinxhir.

- Minimumi 4 dalje presioni normal me diametër 2 e ½ të pajisura me rakorde lidhëse 2 e ½ kapakë të verbër dhe valvula sferike, të pozicionuara në pjesën e pasme.
- 1 dalje me valvul sferike për rrotullin e zorrës (hose reel).
- 1 linjë mbushjeje nga pompa në rezervuar me valvul sferike me çerek rrotullimi.
- 1 dalje për operimin e monitorit të çatisë.
- 1 linjë thithjeje nga rezervuari te pompa.
- **Sistemi i thithjes/mbushjes (Priming system):** Pompë thithëse me piston të dyfishtë; operim automatik përmes presionit të pompës zjarrfikëse, me lartësi maksimale thithjeje jo më pak se 7 m

5. Sistemi i Dozimit të Shkumës

- **Tipi:** Ndërmjetësues manual rreth pompës.
- **Funksioni:** I rregullueshëm për prodhimin e përzierjes së ujit dhe shkumës që do të dërgohet përmes linjave të dorës dhe rrotullit të zorrës, me aftësi thithjeje si nga rezervuari i mjetit ashtu edhe nga burime të hapura uji.
- **Pajtueshmëria:** I përshtatshëm për të gjitha llojet e shkumës, me rregullim të përqindjes së dozimit minimumi në gamën 1% deri në 6%

6. Monitori i Çatisë (Monitor)

- **Funksioni:** I kombinuar për përdorim me ujë dhe shkumë.
- **Pozicioni:** I montuar mbi kuvertën e punës (çati) të automjetit.
- **Komandimi:** Kontroll manual nga çatia / platforma.
- **Kapaciteti i shkarkimit (Prurja):** Jo më pak se 2,400 lt/min

7. Rrotulli i Zorrës me Presion të Lartë (Hose Reel)

- **Sasia:** Minimumi 1 njësi e montuar në ndarjen e pasme.
- **Tipi:** Prej materiali rezistent ndaj korrozionit, me ushqim aksial dhe frenë mekanike; me aftësi ndalimi të rrotullit në çdo pozicion (frenë parandaluese); i përshtatshëm për ujë me presion të lartë dhe shkumë.
- **Guxhoja/Gjuajtësi :** E montuar në fund të zorrës, e përshtatshme për të prodhuar mjegull ujore (spray) ose rrymë të plotë (jet stream), e pajisur me tub për operacione me shkumë.
- **Sistemi i mbledhjes:** Manual dhe elektrik.

8. Sistemi Elektrik dhe Sinjalizimi

- **Komandat e zjarrit brenda kabinës:** Përveç panelit standard të shasisë, pranë ndenjës së shoferit ose bashkëshoferit duhet të ndodhen:
 - Ndërprerësi dhe drita treguese për "FENERËT RROTULLUES"
 - Paneli i kontrollit të "SIRENËS".
- **Sistemi i Alarmit dhe Paralajmërimit:**
 - **Fenerët ndriçues (Beacons):** Minimumi dy fenerë rrotullues/sinjalizues (ngjyrë blu ose e kuqe, të tipit konik ose LED), të montuar mbi çatinë e kabinës.
 - **Sistemi i Ndërlidhjes (P.A. System):** Sistem i integruar me mikrofoni dhe autoparlant për njoftime publike.
 - **Sirena:** Sirenë akustike e cila mund të aktivizohet përmes një ndërprerësi në kroskot dhe furnizimin ta ket me ajër

9. Ngjyra dhe Dokumentacioni

- **Ngjyra e mbindërtimit:** E kuqe zjarrfikëse, standardi RAL 3000.
- **Dokumentacioni (në dorëzim):**
 - Manual operimi.
 - Manual shërbimi dhe mirëmbajtjeje.
 - Katalog i ilustruar i pjesëve të këmbimit.

10. Pajisjet Ndihmëse të Përfshira (Aksesoret)

- **Tuba thithës:** Minimumi 4 copë tuba thithës të përforcuar me diametër 4 inch me gjatësi jo më pak se 2.5 inch secili, të pajisur me rakorde lidhëse mashkull-femër të tipit me vidë.
- **Krepë thithëse:** Minimumi 1 copë krepë me diametër 4 inch për t'u montuar në fund të tubit thithës, për të parandaluar hyrjen e gurëve apo trupave të huaj në pompë.
- **Çelësa tubash:** Minimumi 2 copë çelësa për shtrëngimin/lirimin e tubave thithës.
- **Shkallë e zgjatueshme:** Minimumi 1 copë shkallë alumini me dy zgjatime me sistem tërheqjeje me litar, e lehtë në përdorim, me gjatësi maksimale të hapur jo më pak se 10m e pozicionuar mbi mjet.

Paisje shtese

A. Karakteristikat e Përgjithshme

- **Lloji i pajisjes:** Pajisje celulare kombinuese me bateri dhe me ndricim per naten e projektuar për operatione shpëtimi teknik, e cila kryen funksionet e prerjes, zgjerimit, shtyrjes dhe tërheqjes.
- **Standardet e certifikimit:** Pajisja duhet të jetë plotësisht në përputhje me standardin **EN 13204:2016-12** (ose ekuivalent) dhe të mbajë kodin tregues të certifikimit nga një agjenci testuese e palës së tretë (p.sh. CE, TÜV, etj.).

B. Dimensionet dhe Presioni (Pa Bateri)

- **Gjatësia e pajisjes:** Jo më shumë se 900 mm
- **Gjerësia e pajisjes:** Jo më shumë se 240 mm
- **Lartësia e pajisjes:** Jo më shumë se 260 mm
- **Presioni i punës:** Jo më pak se 700 bar
- **Niveli i mbrojtjes ndaj mjedisit** Minimumi **IP58**
- **Pesha e pajisjes (pa bateri):** Jo më shumë se 18 kg

C. Performanca e Punës

1. Performanca e Zgjerimit

- **Forca maksimale e zgjerimit:** Jo më pak se 1,500 kN
- **Distanca/Hapësira e zgjerimit:** Jo më pak se 370 mm

2. Performanca e Prerjes

- **Forca maksimale e prerjes:** Jo më pak se 490 kN
- **Klasifikimi i prerjes:** Jo më pak se kategoria **112J3J4J5J** në përputhje me standardin EN 13204.

3. Performanca e Tërheqjes

- **Distanca e tërheqjes:** Jo më pak se 380 mm
- **Forca maksimale e tërheqjes:** Jo më pak se 60 kN

D. Bateria dhe Karikuesi

1. Bateria

- **Niveli i mbrojtjes** Minimumi **IP68 (Min)**. Ky nivel mbrojtjeje duhet të zbatohet për baterinë siç dorëzohet, pa pasur nevojë për mbrojtëse shtesë, çanta, mbulesa apo kuti të jashtme izolimi.
- **Kapaciteti i baterisë:** Jo më pak se 9.0 Ah
- **Tensioni (Voltazhi) i baterisë:** Jo më pak se 25 V

2. Karikuesi i Baterisë

- **Niveli i mbrojtjes së karikuesit:** Minimumi **IP20 (Min)**.
- **Gjatësia e kabllit të rrymës:** Jo më pak se 1.8 m
- **Fuqia maksimale në dalje (Output power):** Jo më shumë se 150 W

E. Aksesorët e Përfshirë

- **Kokat për hapje dyresh:** Të ofrohet një set i dedikuar kokash i projektuar posaçërisht për hapjen e dyerve, i cili të jetë plotësisht i pajtueshëm me pajisjen pa pasur nevojë për modifikime. Seti duhet të përbëhet nga:
 - Një (1) kokë për hapje dyresh me dy (2) dhëmbë/gishta.
 - Një (1) kokë për hapje dyresh me tre (3) dhëmbë/gishta.
- **Pesha totale e aksesorëve:** Pesha totale maksimale e kompletit të kokave (të dyja së bashku) nuk duhet të kalojë 2.5 kg

Autorim prodhuesi për shasine, agregatin dhe paisjet

Certifikate konformiteti të bashkimit evropian për shasine, agregatin dhe paisjet